



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1594, datë 04.05.2011

“Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 04.05.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1 dhe neni 60 e vijues, pika te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e ABCom sh.p.k., nr. 132 prot, datë 05.04.2011 (AKEP: nr. 576 prot, datë 05.04.2011) “Paraqitja e mosmarreveshjes midis ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a për tarifën e terminimit në rrjetin e ABCom”;
- Shkresa e ABCom sh.p.k. nr. 67 Prot., datë 24.02.2011, dërguar Vodafone AL “Kërkesë për kthim të garancisë financiare për MI në fuqi”;
- Shkresa e ABCom sh.p.k. nr. 126/1 Prot., datë 31.03.2011, dërguar Vodafone AL mbi tarifën e terminimit në rrjetin e ABCom dhe MI me Vodafone;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- Korrespondenca me e-mail midis palëve,
si dhe
duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. ABCom sh.p.k., është regjistruar pranë AKEP në regjistrin e sipërmarrësve me nr. 24, për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
2. Ankimi administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi ABCom sh.p.k me shkresën nr. 132 prot, datë 05.04.2011, është në përputhje me:
 - Pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
 - Rregulloren nr. 18, datë 11.06.2010, “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” miratuar me VKD nr. 1296 datë 11.06.2010;
3. ABCom sh.p.k., me shkresën nr. 132, datë 05.04.2011 “Paraqitja e mosmarreveshjes midis ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a për tarifën e terminimit në rrjetin e ABCom” drejtuar AKEP sqaron se:
 - Procesi i negocimit për lidhjen e Marrëveshjes së re të Interkoneksionit me Vodafone AL ka filluar në muajin Janar 2011. ABCom në përputhje edhe me ORI të re i ka paraqitur Vodafone draft marrëveshjen e interkoneksionit, në të cilin është vendosur tarifa e terminimit në rrjetin e ABCom me vlerë 2.5 lekë/min. ABCom argumenton se, kostot e terminimit në rrjetin e tij si operator alternativ janë të ndryshme nga ato të Albtelecom dhe se aplikojnë një asimetri prej +30% me Albtelecom sh.a;
 - Kjo tarifë është kundërshtuar nga Vodafone AL (email-et e datave 25.03.2011 dhe 01.04.2011), me pretendimin se tarifa e terminimit në rrjetin e ABCom duke filluar nga data 1 Mars 2011, duhet të jetë 1.54 lekë/ min, dhe të mos aplikohet tarifë për thirrje;
4. Vodafone AL, e konsideron të paparanueshëm e të pabazuar nga ana ligjore, ashtu edhe rregullatore, qëndrimin e ABCom për rritje të tarifës së terminimit në vlerën 2.5 lekë/min. Vodafone AL, argumenton qëndrimin e vet me faktin se zona e operimit të serive numerike të ABCom është në Tiranë, duke i bërë referencë segmentit lokal të terminimit të thirrjes në rrjetin fikse, tarifa e terminimit të së cilës është më e ulët se propozimi i Vodafone AL;
5. Për sa më sipër, Vodafone AL thekson se, nuk do të pranojë të njohë asnjë faturë të

lëshuar nga ABCom me tarifë terminimi të ndryshme nga 1.54 lekë/min;

6. Duke qenë se, sipërmarrësit ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a., megjithë negociatat, takimet dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord mbi tarifën e terminimit në rrjetin e ABCom, dhe si rrjedhojë në moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP në zbatim edhe të nenit 50 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, te Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis “ABCom” sh.p.k dhe “Vodafone Albania” sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Jonida Gjika Kryetar
 - Përparim Buçaj Anëtar
 - Jetmir Braha Anëtar
 - Ded Jakaj Anëtar
 - Florida Çela Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara ABCom sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**